



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 135, datë 24.11.2022

PËR
MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARES
ZNJ. VALBONA BEGIÇI

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1 gërma “b”, neni 49, pika 4 gërma “e”, pika 5, neni 54 pika “j”, nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, dhe në zbatim të nenit 20, pika 1 gërma “g” dhe pika 16, neni 43, pika 2 gërma “d” dhe “k” të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkisë Durrës, me propozim të Komisionit të Mandateve të këshillit,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Mbarimin para afatit të mandatit të këshilltares së Këshillit Bashkiak Durrës znj. Valbona Hasan Begiçi, nga lista shumëemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6 mujore.
2. Të shpall vakancën në Këshillin Bashkiak Durrës.
3. Për këtë vendim të njoftohet Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

4. Në komisionet e këshillit të bëhen ndryshimet si më poshtë :

- a. Në Komisionin e Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë në vënd të këshilltares znj. Valbona Begiçi, që ushtronte detyrën si anëtare i këtij komisioni të emërohet këshilltarja zj.Floresha Qoshi, përkohësisht deri në marrjen e mandatit të një këshilltari të ri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari Këshillit Bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 25.11.2022





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 899 / prot.
3

Durrës, më 07/12 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.135 datë 24.11.2022
“Për mbarimin para afatit të mandatit të këshilltares Znj.Valbona Begiçi”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për
Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

